AUTORIZIM ZYRTAR
Nr. 4, datë 8.6.2000

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI

Në mbështetje të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996, "Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit", ndryshuar me ligjin nr.8606, datë 27.4.2000, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit", ndryshuar me ligjin nr.8548, datë 11.2.1999, të akteve të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit, si dhe Autorizimit të Ministrit të Financave nr.2290/3 Prot, datë 1.6.1999,

KOMISIONI I MBIKQYRJES SË SIGURIMEVE

AUTORIZON

Shoqërinë Anonime "Instituti i Sigurimeve" sh.a, me emrin e shkurtuar "INSIG" sh.a me seli në Tiranë, e regjistruar në Gjykatën e rrethit Tiranë me nr.Akti 21 463, datë 8.6.1999, të kryejë sigurime për jetën, në përputhje me Lejen për ushtrim aktiviteti.